

**FJALA E MBAJTUR NGA KREU I PREZENCËS SË OSBE NË
SHQIPËRI NË CEREMONINË PËR NËNSHKRIMIN E
MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
DEPARTAMENTI I GAZETARISË, UNIVERSITETI I TIRANËS
15 PRILL 2013**

*Profesor Rrokaj,
Profesor Fuga,
Studentë të dashur*

Është kënaqësi që jam këtu sot në cilësinë time si Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Veçanërisht, jam i lumtur të shoh gjithë këta të rinj, të ardhmen e vendit.

Sot ne nisim zyrtarisht atë që mund të konsiderohet si një projekt emocionues bashkëpunimi midis Prezencës së OSBE-së dhe Departamentit të Gazetarisë së Universitetit të Tiranës – një projekt në të cilin ju, studentë të dashur, do të luani një rol kyç.

Ashtu siç jeni të gjithë në dijeni, supozoj, në Shqipëri po afrojnë zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit. Ky do të jetë sërish një test i rëndësishëm për pjekurinë demokratike të Shqipërisë. Duket sikur i gjithë procesi zgjedhor dhe jo vetëm dita e zgjedhjeve në vetvete do të kenë një ndikim në shanset e Shqipërisë për integrim të mëtejshëm evropian.

Rëndësia e procesit parazgjedhor nuk mund të theksohet mjaftueshëm. Media ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në procesin zgjedhor, i cili është në vazhdim e sipër, përsa i takon informimit të qytetarëve. Për të përmendur vetëm dy shembuj, kjo mund të jetë për programet e partive politike apo platformat e kandidatëve. Përmes raportimit objektiv dhe të balancuar, ata mund të kontribuojnë për konsolidimin e demokracisë në Shqipëri.

Edhe pse kanë një përgjegjësi kaq të madhe, organet mediatike në Shqipëri nuk janë shumë të njohura për zbatimin e parimeve të gazetarisë etike, sidomos gjatë periudhave të fushatës zgjedhore. Prezenca e OSBE-së dhe Departamenti i Gazetarisë i Universitetit të Tiranës po bashkojnë forcat për të bërë punë kërkimore dhe analizim të praktikave të redaksive të ndryshme. Kjo do të na ndihmojë që të kuptojmë më mirë shkaqet e mangësive profesionale dhe etike nga ana e medias.

Rezultati i kësaj përpjekjeje duhet të na ndihmojë që të identifikojmë elementët e mundshëm që mungojnë në procesin e dhënies formë të lajmeve dhe informacionit. Në shkëmbim, kjo do të ofrojë një bazë për zhvillimin e zgjedhjeve për të adresuar problemin përmes asistencës për agjencitë e lajmeve dhe gazetarëve që punojnë për to.

*Profesor Rrokaj,
Profesor Fuga,
Studentë të dashur,*

Shpresoj që ky projekt të jetë i vlefshëm për ju. Ne e shohim si tejet konstruktiv për të ndihmuar në krijimin e një shoqërie më të mirë informuar, një platformë solide për një demokraci të qëndrueshme.

Ju uroj të gjithëve shumë suksese në studime!

Ju falemnderit shumë!